

Departamenti i Shërbimeve Publike 26-50 – Shoqëria Boston Gas d/b/a National Grid
Letër informuese

Më 15 janar 2026 ose më pas, Shoqëria Boston Gas, d/b/a National Grid (“National Grid” ose “Shoqëria”), do të paraqesë pranë Departamentit të Shërbimeve Publike (“Departamenti”) një petition për të përditësuar planin bazë të tarifës së shpërndarjes së Shoqërisë. Qëllimi i këtij dokumenti është të kërkojë që Departamenti të shqyrtojë dhe miratojë një përditësim të tarifave të Shoqërisë për shpërndarjen e gazit. Shoqëria ka hartuar këtë dokument për të zbatuar ndryshimet e tarifave më 1 janar 2027, bazuar në tarifat në fuqi më 1 dhjetor 2026.

Paraqitja e kërkesës, e njohur edhe si "çështje tarifash", është një proces formal ku një shoqëri që ofron shërbime, si është National Grid, kërkon miratimin nga Departamenti për të ndryshuar tarifat që u tarifon klientëve të saj. Ky proces i lejon një shoqërie të shërbimeve publike të propozojë tarifa të reja që pasqyrojnë kostot aktuale të ofrimit të shërbimeve të shpërndarjes së gazit natyror për klientët e saj.

Nëse miratohet sipas kërkesës së paraqitur, rritja e kërkuar përfaqëson një ndikim mesatar prej 8.4 përqind, ose 24 dollarë në muaj, për klientët që përdorin ngrohjen me gaz në vendbanimet e tyre dhe që ndodhen në zonën e ish- shërbimit të Shoqërisë Boston Gas gjatë periudhës së faturimit gjatë sezonit të dimrit. Për klientët që përdorin ngrohjen me gaz në vendbanimet e tyre dhe që ndodhen në zonën e ish- shërbimit të Shoqërisë Colonial Gas, rritja e kërkuar përfaqëson një ndikim mesatar prej 9.4 përqind, ose 25 dollarë në muaj, për periudhën e faturimit gjatë sezonit të dimrit.

Nëse keni nevojë për shërbime shtesë përkthimi ose interpretimi për seancat dëgjimore publike, ju lutemi kontaktoni christine.milligan@nationalgrid.com.

Kini parasysh se përmbledhja e mësipërme ofrohet vetëm për qëllime informuese dhe nuk ka për qëllim të zëvendësojë ndonjë njoftim zyrtar të lëshuar nga Departamenti në lidhje me këtë çështje.